



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2021:087255

Datë: 28.12.2023

Numri i dokumentit: 05229963

**PPP. nr.680/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtaren Fatbardha Uka Ibrahimimi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit KRM “P.” Sh.a, me seli në P., kundër debitorit E.Z., nga Komuna e F. K., fsh., lidhur me çështjen përmbartimore, për shkak të borxhit në shumën prej 615.6 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhrit përmbartimor P.nr.342/21, të datës 30.03.2021, të lejuar nga përmbartuesi privat Driton Govori, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.12.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. PRANOHET pjesërisht** prapësimi i debitorit E.Z., nga F. K., dhe **SHFUQIZOHET** urdhri përmbartimor P.nr.342/21, të datës 30.03.2021, lejuar nga përmbartuesi privat Driton Govori, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, për pjesën e detyrimit në shumë prej 549.80 €.
- II. REFUZOHET pjesërisht** prapësimi i debitorit E.Z., nga F.K., ashtu që **MBETET NË FUQI** pjesa tjetër e urdhrit përmbartimor P.nr. 342/21 të datës 30.03.2021, i lejuar nga përmbartuesi privat Driton Govori, për pjesën e detyrimit në shumë prej 65.80 €.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi privat, Driton Govori, si organ përmbartues, sipas propozimit të kreditorit KRM. “P.” ka lëshuar urdhrin përmbartimor 342/21 të datës 30.03.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstrakti nga librat afarist, në shumë prej 615.60 €, me të cilin ka kërkuar që debitori të obligohet që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të urdhrit t’i paguaj kreditorit borxhin prej 615.60 €, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e lejimit të përmabrimt e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër urdhrorit përmbartimor P.nr.342/21 të datës 30.03.2021, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim debitori me ç'rast ka kundërshtuar propozimin për përmbartim të kreditorit, duke theksuar se në bazë të dispozitave të LMD-së, shpenzimet për shërbimet komunale parashkruhen për një vit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe anulohet në tërësi urdhri përmbartimor si i pabazuar.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, nga këto arsye:

Sipas ekstraktit të verifikuar nga librat afarist, gjykata gjeti se borxhi është kërkuar për periudhën nga data 31.07.2010 deri më datë 28.02.2021, në shumën totale prej 615.60 €, ndërsa propozimi për përmbartim lidhur me borxhin e lartcekur është paraqitur më datë 30.03.2021, i lejuar me urdhrin përmbartimor Nr. 342/21 të datës 30.03.2021.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e nenit 378 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare nr.29/78), e cila ka qenë në fuqi për periudhën e krijimit të të borxhit nga data 31.07.2010 deri më datë 19.12.2012. Kurse periudha pas datës 19.12.2012 e deri në arritjen e borxhit të fundit për pagesë, përkatësisht më datë 28.02.2021, mbulohet me nenin 360 par. 1 të Ligjit Nr. 04/L077 të Marrëdhënieve të Detyrimeve, sipas së cilit parashihet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti: (1.1.) kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa sipas paragrafit 2 të njëjtit nen është përcaktuar: *“afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*, andaj rrjedhimisht duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, u vërtetua se kërkesat e kreditorit për shërbimet nga data 31.07.2010 e deri më datë 31.12.2019, në shumë prej 549.80 €, kanë arritur afatin e parashkrimit, kjo meqenëse propozimi për përmbartim është paraqitur më datë 30.03.2021 dhe si të tilla kërkesat për periudhën e lartcekur kanë arritur më tepër së një vit nga koha e maturimit të së njëjtave për pagesë, ashtu siç është vendosur në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Ndërsa për pjesën e mbetur sipas propozimit të kreditorit, përkatësisht për periudhën nga data 01.01.2020 deri më datë 28.02.2021, në shumën prej 65.80 €, gjykata erdhi në përfundim se borxhi lidhur më shërbimet e ofruara për gjatë kësaj periudhe, nuk ka arritur afatin e parashkrimit sipas dispozitave të lartcekura, meqenëse propozimi për përmbartim është paraqitur më datë 30.03.2021, andaj vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 43 par. 4 të Ligjit Nr. 04/L-139 të Procedurës Përmbartimore, parashihet se: *Përmbartuesit privat nxjerrin urdhrin për përmbartueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbartueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngreh kundërshtimin ndaj urdhrorit të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për*

*nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.”*

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, prandaj pjesërisht shfuqizoj urdhrin përmabrimor.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**PPP.nr.680/21, datë 28.12.2023**

**Gj y q t a r j a**  
**Fatbardha Uka Ibrahim**

***KËSHILLA JURIDIKE:*** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme.